



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.99/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit NSHT “C...” me seli në rr.“...”, nr. ..., Prishtinë, e përfaqësuar nga B.B, kundër debitorit “PTK” sh.a, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 441/14 të datës 03.10.2014 të Përmbartuesit Privat Gjokë Radi me seli në Gjakovë, jashtë seancës me datën 20.03.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “PTK” sh.a, me seli në Prishtinë, ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr. 441/14 i datës 03.10.2014 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi, me seli në Gjakovë, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit NSHT “C...” me seli në Prishtinë, ka caktuar Urdhërin Përmbartimor P.nr. 441/14 të datës 03.10.2014 duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturave Nr. 1278 të datës 04.09.2012, Nr. 1282 të datës 05.09.2012, Nr. 1284 të datës 06.09.2012, Nr. 1287 të datës 07.09.2012, Nr. 1289 të datës 10.09.2012, Nr. 1296 të datës 11.09.2012, Nr. 1302 të datës 12.09.2012, Nr. 1308 të datës 13.09.2012, Nr.1309 të datës 14.09.2012, Nr. 1387 të datës 17.10.2012, Nr. 1386 të datës 17.10.2012, Nr. 1385 të datës 17.10.2012, Nr. 1384 të datës 17.10.2012, Nr.1383 të datës 17.10.2012, Nr.1382 të datës 17.10.2012, Nr.1381 të datës 17.10.2012, me të cilat e ka detyruar debitorin, që në afat prej 7 (shtatë) ditësh na dita e pranimit të këtij urdhri t’ia paguaj kreditorit në

emër të borxhit kryesor shumën prej 1.500.00€, së bashku me kamatë ligjore nga dita lejimit të përbarimit ke deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur në kohë sipas ligjit, e ka kundërshtuar urdhërin përbarimor në tërësi si të pabazuar nga shkak se debitori nuk ka krijuar kurrfarë raporti juridik me kreditorin dhe mbi këtë bazë nuk ka kurrfarë obligimesh ndaj tij. Tutje ka shtuar se Përbaruesi Privat ka lejuar dhe caktuar ekzekutimin e propozuar ndaj PTK-së pa kurrfarë mbështetje ligjore dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe të LMD-së, ku propozimit i ka bashkangjitur disa fatura të cilat nuk janë protokoluara tek debitori dhe nuk janë të nënshkruara nga personat e autorizuar. Më pas ka theksuar se nga shkresat e bashkangjitura nga vetë kreditori rezulton se të gjitha faturat kontestuese janë të subjektit tjetër juridik, përkatësisht të subjektit të pavarur juridik, Posta e Kosovës, e jo të PTK-së ndërsa kjo vërtetohet edhe nga një listë e bashkangjitur me emrat e punëtorëve të Postave të Kosovës sikurse janë: M.I; A.F, etj., dhe se bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.16/53 të datës 21.12.2011 është themeluar Ndërmarrja Publike Qendrore, Posta e Kosovës sh.a, ndërsa e njëjta është regjistruar si subjekt juridik me datën 04.05.2012 pranë ARBK-së. Në fund debitori i ka propozuar Gjykatës që të aprovoj prapësimin e debitorit, të abrogoj Urdhërin Përbarimor P.nr.441/14 të datës 03.10.2014 si dhe të obligohet kreditori që t'i bartë shpenzimet e procedurës, në lartësinë të cilën e përcakton Gjykata.

Lidhur me prapësimin e ushtruar kundër Urdhërit Përbarimor P.nr. 441/14 të datës 03.10.2014, kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në prapësim.

Gjykata në ri procedurë duke vepruar sipas sugjerimeve dhe vërejtjeve të Gjykatës së Apelit sipas vendimit Ac.nr.4400/17 të datës 25.04.2018, e pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përbarues ka lejuar përbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në*

bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”

Gjykata vlerëson se në rastin konkret në faturat e lartcekura, në bazë të cilave është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - faturat në bazë të së cilave është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për faktin se faturat në rastin konkret janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk janë pranuar nga debitori, përkatësisht të njëjtat nuk përmbajnë nënshkrimin e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se të njëjtat janë pranuar nga debitori. Andaj, duke qenë se debitori nuk i ka pranuar në mënyrë të rregullt faturat, si të tilla të njëjtat nuk mund të shërbejnë si dokumente të besueshme dhe nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm-faturat mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilave Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin, nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e Përmbaruesit Privat duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe

nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm

KPPP.nr.99/22, datë 20.03.2023

Gjyqtar
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.